

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-14/13

**Prishtinë/Priština,
15 maj 2013**

Në çështjen juridike të

V.D.

Mali i Zi

Paraqitësja e kërkesës/Pala ankuese

kundër

Xh. G.

Pejë

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur me ankesat kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK /D/A/149 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA28994) të datës 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 15 maj 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e V. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/149/2012 i datës 19 prill 2012 sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA28994.
- 2- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/149/2012 i datës 19 prill 2012 sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numër KPA28994.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 45 (katërdhjetë e pesë) brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 19 shtator 2007, V. D. paraqiti disa kërkesa pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin. Ndër ngastrat e kërkuara ishte ngastra nr. 4940/1, që ndodhet në Jerinjak-Krivoglave, një fushë e klasit të 3-të me sipërfaqe prej 23 ari dhe 44 m². Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA28994.

Më 31 korrik 2008 Xh. G. u përgjigj se babai i tij e kishte blerë ngastrën në vitin 1991.

Paraqitësja e kërkesës e konfirmoi këtë me letrën e 16 shtatorit 2009 dhe shtoi se Xh. G. kishte kërkuar të blejë ngastrat e mbetura (me sa duket të kërkuara me kërkesat tjera në AKP). Nga letra e paraqitëses së kërkesës të datës 25 qershor 2010 mund të konkludohet se palët nuk ishin marrë vesh rreth çmimit dhe se paraqitësi i kërkesës dëshironte t'ia shiste ngastrat një personi tjetër me çmim që sipas mendimit të saj ishte çmimi i drejtë. Me letrën e saj të datës 8 korrik 2011, paraqitësja e kërkesës për herë të parë kërkoi që “organet kompetente të reagojnë duke na mundësuar ta shesim pjesën e mbetur të pronës të cilën e posedojmë dhe t'i ofrojmë z. Xh. G. që t'i blejë të gjitha pjesët e mbetura të tokës me një çmim real”.

Me vendimin e vet KKPK/D/A/149/2012 të datës 19 prill 2012, KKPK hodhi poshtë kërkesën meqë humbja e posedimit nuk ishte e ndërlidhur me konfliktin e armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999.

Më 6 nëntor 2012, paraqitësja e kërkesës (më tutje: pala ankuese) nëpërmjet Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së paraqiti një ankesë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me lëndën nr. KPA28994 (ajo nuk përmendi ndonjë vendim të KKPK-së pasi që në atë kohë KKPK-ja ende nuk e kishte dhënë vendimin e vet). Ajo deklaroi se ankohej kundër vendimit të KKPK-së në tërësi dhe pjesërisht, lidhur me ngastrat nr. 4940/2 dhe 4940/3. Ajo theksoi se nuk konteston se ngastra nr. 4940/1 i ishte shitur babait të palës përgjegjëse në kërkesë. Ajo kërkoi, megjithatë, që të kontaktohet pala përgjegjëse në kërkesë dhe t'i ofrohet blerja e dy ngastrave tjera ose t'i lejohet asaj shitja e lirë e këtyre ngastrave. Nëse të dyja palët nuk arrijnë një marrëveshje, ajo do të detyrohet të paraqesë ankesë para Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strazburg.

Vendimi i KKPK-së iu dërgua paraqitëses së kërkesës më 6 dhjetor 2012.

Pala përgjegjëse nuk u përgjigj në ankesë.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e lejueshme, megjithatë e pabazuar.

Pala ankuese shprehimisht pranon se ngastra 4940/1 ishte shitur. Rrjedhimisht, ajo e pranon vendimin e KKPK-së.

Megjithatë, pala ankuese kërkon nga KKPK/Kolegji i Apelit të AKP-së të bëjnë më shumë sesa të vendosin rreth kërkesës së saj fillestare. Ajo kërkon nga autoritetet që ta detyrojnë palën përgjegjëse në ankesë t'i blejë ngastrat 4940/2 dhe 4940/3 ose së paku që ai të pajtohet për shitjen e tyre.

Kjo nuk është e mundshme për disa arsye:

KKPK-ja dhe Kolegji i Apelit të AKP-së janë kompetent t'i zgjidhin vetëm kërkesat pronësore dhe kërkesat lidhur me të drejtat e shfrytëzimit të pronës (neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me ligjin nr. 03/L-079). Kjo do të thotë, për shembull, se KKPK mund t'ia njohë

pronësinë një pale dhe t'ia aprovojë ri-posedimin. Megjithatë, KKPK nuk ka të drejtë ta detyrojë ndonjërin që ta blejë një ngastër apo ta detyrojë atë të pajtohet që ngastra të shitet (nëse ky miratim do të ishte fare i domosdoshëm për një shitje). KKPK-ja nuk ka mandat të jetë ndërmjetës midis palëve kontraktuese.

Së dyti, kërkesa e palës ankuese nuk është aspak e ndërlidhur me konfliktin e armatosur që ndodhi në Kosovë në vitet 1998/1999. Kjo, megjithatë, gjithashtu do të ishte kusht për juridiksionin e KKPK-së/ Kolegjit të Apelit të AKP-së (neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me ligjin nr.03/L-079).

Së treti, paraqitësja e kërkesës paraqiti kërkesën e saj për herë të parë në vitin 2011. Meqë kërkesat për AKP-në/KKPK-në kanë mundur të paraqitën në mënyrë të vlefshme pranë AKP-së vetëm deri më 3 dhjetor 2007 (neni 8 i Udhëzimit Administrativ 2007/5 i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079), kërkesa do të ishte e vonuar edhe nëse do të ishte nën juridiksionin e KKPK-së.

Rrjedhimisht, ankesa është dashur të hidhet poshtë si e pabazuar (neni 13.3 c) i Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin 03/L-079; Neni 195.1 d0 të Ligjit të Procedurës Kontestimore).

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e kërkesës mbi të cilën Gjykata ka vendosur në mënyrë të arsyeshme mund të përllorarit të jetë € 1.000: € 15 .

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata vendos të jep një afat prej 90 ditësh. Neni 47.3 të këtij Ligji parashikon që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet përmbarimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me anë të mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it